

EDMOND MALAJ

**LUFTA ANTIOSMANE DHE MARRËDHËNIET
E SKËNDERBEUT ME JANOSH HUNIADIN
DHE TË BIRIN E TIJ, MATIAS KORVININ**

Abstrakt:

Në artikull trajtohen kryesisht marrëdhëniet e Skënderbeut me Janosh Huniadin, një ndër figurat më të rëndësishme të luftës antiosmane në Evropë, dhe sot edhe një ndër heronjtë kryesorë të Hungarisë. Krahas këtyre marrëdhënieve trajtohen shkurt edhe ato me të birin e Huniadit, Matias Korvinin, i cili më vonë u bë Mbret i Hungarisë. Duke iu përmbajtur edhe kuadrit që ka një artikull, në lidhje me këto marrëdhënie jepen dhe të dhëna kryesore, të cilat janë nxjerrë kryesisht qoftë nga literatura e huaj, e vjetër dhe bashkëkohore, e cila në pjesën më të madhe është e panjohur akoma për studiuesin shqiptar, qoftë edhe në dokumente të cilat janë dhënë si të përkthyer, ashtu edhe në gjuhën origjinale.

Fjalë kyçe:

Skënderbeu, Janosh, Huniadi, Matias Korvini, fronti antiosman, Beteja e Jalomicës, Beteja e Nishit, Beteja e Varnës, Beteja e Kosovës, Papa Piu II, Vladislavi II, Gjergj Brankoviq, Sulltan Murati II.

Marrëdhëniet e Skënderbeut me Shtëpinë Huniadi, së pari me Janosh Huniadin dhe më vonë edhe me të birin e tij, Matias Korvini, zgjatën për shumë vite. Ato duhet të kenë filluar diku në vitin 1440 dhe përfunduan me vdekjen e Skënderbeut në vitin 1468. Gjatë kësaj periudhe të gjatë prej 28 vitesh ka disa momente kryesore, të cilat mund të konsiderohen si pika kulminante të këtyre marrëdhënieve. Ato janë të lidhura me luftën antiosmane dhe u përkasin viteve 1443-1444, 1448 dhe 1464.

Në fillim po trajtoj marrëdhëniet e Skënderbeut me Janosh Huniadin, të cilat janë edhe përmbajtja thelbësore e këtij artikulli. Për sa i përket Janosh Huniadit vlen këtu që të përmendim disa fakte për këtë figurë të rëndësishme jo vetëm për historinë hungareze, por edhe për frontin antiosman në kohën e Skënderbeut. Janosh Huniadi që përfshirë në luftën

antiosmane qysh në vitin 1435, duke u shquar në shumë raste.¹ Në fakt,



Fig. 1: *Skënderbeu dhe Huniadi*, pikturë e shek. XVIII. Burimi: M. Mala, *Shqiptarët dhe Evropa Qendrore gjatë shek. XII-XVII*, f. 215.

Huniadi, i lindur në Huneadora të Transilvanisë dhe fisnik rumun është i lidhur kaq ngushtë me historinë hungareze, saqë mund të quhet “embrion i shtetit hungarez”.² Ai ishte një prijës ushtarak i lindur, një komandant i shquar, por ishte i padurueshëm dhe nuk kishte cilësitë e një burri shteti,³ megjithatë ai mbetet një ndër figurat e shquara sidomos në luftën kundër osmanëve.

Skënderbeu dhe Huniadi gjatë Betejës së Szebenit

Ka shumë të ngjarë që Skënderbeu dhe Huniadi i patën kontaktet e para ndërmjet njëri-tjetrit qysh në fillim të viteve 40 të shek. XV. Pikërisht në këtë periudhë, në vitin 1442 (sipas studimeve në vitin 1440) në Szeben (gjerm. *Herrmannstadt*)⁴ pati sulme nga osmanët nën komandën e Mesid Pashës, në ushtrinë e të cilit bënte pjesë edhe Skënderbeu. Këto sulme u thyen me sukses nga Huniadi.⁵ Mbi këtë ngjarje japin të dhëna disa

¹ Pál Engel, “János Hunyadi and the Peace “of Szeged” (1444)”, në *Acta Orientalia Academiae Scientiarum Hungaricae*, Tomus XLVII (3), Hungarian Academy of Sciences, Budapest: 1994, f. 241.

² Ferdinand Schevill, *Ballkani. Historia dhe qytetërimi*, përkthyer Mitro Çela, Enian Çela, Tiranë: Uegen, 2002, f. 162.

³ Po aty.

⁴ Karl Nehring, “Hunyadi, Johann/János”, në *Biographisches Lexikon zur Geschichte Südosteuropas*, Bd II G-K. Hrsg von Mathias Bernath und Felix v. Schoeder, Redaktion Gerda Bartl, München: R. Oldenburg, 1976, f. 194.

⁵ Oliver Jens Schmitt, “Matthias Corvinus und Skanderbeg oder die jahrzehntelange Allianz der Häuser Hunyadi und Kastrioti im Krieg mit den Osmanen”, në *Matthias Corvinus und seine Zeit. Europa am Übergang vom Mittelalter zur Neuzeit zwischen Wien und Konstantinopel*, Herausgegeben von Christian Gastgeber, Ekaterini Mitsiou, Ioan-Aurel Pop, Mihailo Popović, Johannes Preiser-Kapeller, Alexandru Simon, Wien: ÖAW, 2011, f. 9 (Online edition, doi:10.1553/0x0028e842). Në veprën e Xhefersonit jepet data 18-22 mars 1442 dhe në lidhje me këto ngjarje Skënderbeu nuk

autorë. Ndër ta vlen të përmenden edhe prifti katolik Martin Segoni, ipeshkëv i qytetit të Ulqinit.

Martin Segoni që konsiderohet madje edhe si biografi i parë i Skënderbeut, shkruan 10 vjet pas vdekjes së heroit dhe e përmend shkurt edhe ngjarjen e Szebenit, pa dhënë detaje të mëtejshme.⁶ Pikërisht gjatë kësaj periudhe Skënderbeu ishte aktiv në mënyrë të fshehtë, duke u organizuar që të hiqte më vonë zgjedhën osmane nga territoret e tij dhe të merrte aty pushtetin⁷, dhe nuk është aspak e habitshme që ai të ketë mbajtur kontakte të fshehta qoftë me Huniadin, qoftë me prijësit dhe potentatë të tjerë të krishterë. Megjithatë, për sa i përket këtij supozimi, akoma mungojnë dokumente⁸ dhe të dhëna të mëtejshme. Studiuesi hungarez Tamás Pálosfalvi, është i mendimit që ka një mungesë provash dhe evidencash edhe në lidhje me kontakte a takime që mund të kenë pasur personalisht me njëri-tjetrin Skënderbeu me Huniadin.⁹ Pra, pyetja: “A janë takuar ndonjëherë Skënderbeu me Huniadin?” mbetet edhe sot akoma pa një përgjigje.

Për sa i përket Huniadit, me gjithë gjendjen e vështirë në Hungari¹⁰, ai gjatë viteve 1441 dhe 1442 korri shumë fitore të rëndësishme mbi

përmendet fare. Shih: John Jefferson, *The Holy Wars of King Wladislas and Sultan Murad: The Ottoman-Christian Conflict from 1438-1444*, Leyden: Brill, 2012, f. 209.

⁶ “...Nell’ istesso tempo Giorgio Scanderbech, essendo stato rotto nella Transilvania Mesitbech, sotto di cui alhora militava, offerasiggli questa occaisione di partirsi da i Turchi, se n’ando in Tessaglia...”. “Martin Segoni-Humanist në Shqipëri në shekullin XV”, në Dhimitër S. Shuteriqi, *Marin Beçikemi dhe shkrime të tjera*, Tiranë: Naim Frashëri, 1987, f. 33.

⁷ J. Jefferson, *The Holy Wars...*, f. 367.

⁸ Ekzistojnë në fakt një numër i caktuar letrash, pjesë të letërkëmbimeve ndërmjet Skënderbeut dhe Mbretit Vladislav apo ndërmjet Skënderbeut dhe Janosh Huniadit, letra këto që e kanë origjinën më së shumti nga Marin Barleti, biografi i Skënderbeut. Këto materiale nga shumë studiues konsiderohen si fiktive dhe duhet të përdoren me kujdes. Shih përmbajtjen e tyre edhe tek: Jovan Radonić, *Durađ Kastriot Skenderbeg i Abanija u XV Beku*, (Istoriska Grača), Srpska Kraljevka Akademija, Beograd: 1942, dok. nr. 9, 10. [=Spomenik XCV. Drugi razred. Nr. 74]

⁹ Tamás Pálosfalvi, “Skanderbeg and John Huniadi: Myth and Reality”, në *Shqipëri-Hungari dje, sot dhe nesër*, Konferencë shkencore ndërkombëtare, Shkodër, 18 nëntor 2016, Artan Haxhi (përg.), Studime Shqiptare 28, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Shkodër: Florentia 2017, f. 67.

¹⁰ Si rrjedhojë e ngatërresave të brendshme në Hungari, ku u bë një kurorëzim i dyfishtë (Vladislavi katër muajsh që kishte lindur pas vdekjes së të atit (Ladislavus Posthumus) u kurorëzua si Mbret në maj 1440, kurse Vladislavi III u kurorëzua si Mbret i Hungarisë në qershor të po atij viti). *Skanderbeg. Historische Studie von Julius Pisko*

trupat turke dhe këto fitore e detyruan Muratin II të dërgonte në Zibenbyrgen përtej Danubit një ushtri prej 80 000 vetash nën komandën e Shahinit. Megjithatë kjo ushtri u asgjësua nga Huniadi te kalimi i Portës së Hekurt në jugperëndim të Zibenbyrgenit.

Beteja pranë lumit Jalomica, në vitin 1442

Në vitin 1442 pati pastaj edhe një ikje tjetër të Skënderbeut mbi Danub, këtë herë nga fusha e Betejës së Jalomicës të Vllahisë, ku osmanët më 2 shtator të po këtij viti u sulmuan dhe u mundën nga Huniadi, i cili kishte në dispozicion vetëm 15.000 trupa.¹¹ Komandanti i ushtrisë turke ishte eunuku Sabahedin (ose Shihabedin) Pasha (Shihab ed-Din Pash) i Rumelisë, i cili arriti të shpëtonte, edhe pse në një kronikë me titull “Kronikë e pushtimeve turke në Serbi”, e cila është gjetur e shkruar në gjuhën sllave, së cilës po i referohemi, shkruhet sikur ai të jetë vrarë aty nga Janosh Huniadi.¹² Mirëpo, kjo e dhënë është e gabuar, sepse ai shfaqet nëpër kronika të ndryshme disa herë edhe më vonë dhe merr pjesë në mënyrë aktive në ardhjen përfundimtare në fron të Sulltan Mehmetit II, më 18 shkurt 1451.¹³

Sipas “Kronikës bizantine lokale të Mesembrias”,¹⁴ ushtria osmane pësoi humbje të mëdha dhe numri i turqve të rënë jepet me 28 000 vetë.¹⁵

K. u. K. Vice-Consul und Leiter des K. u. K. Oest.-Ung. General-Consulates in Janina, Wien: K. U. K. Hofbuchhandlung Wilhelm Frick, 1894, f.13. (cituar më pas: J. Pisko, *Skanderbeg...*)

¹¹ Vilmos von Zsolnay, *Vereinigungsversuche Südosteuropas im XV. Jahrhundert*, Frankfurt/Koblenz: Selke 1967, f. 52.

¹² Peter Schreiner, *Die Byzantinischen Kleinchroniken*. 3. Teil. Teilübersetzungen, addenda et corrigenda, Indices. Wien: Österreichische Akademie der Wissenschaften 1979, nr. 72a/29, f. 116. [= *Corpus Fontium Historiae Byzantinae*, Volumen XII/3: *Chronica Byzantina Breviora*.]; shih edhe: Peter Schreiner, *Die Byzantinischen Kleinchroniken*. 2. Teil. Historischer Kommentar. Wien: Österreichische Akademie der Wissenschaften 1977, dok. nr. 29, f. 462.[= *Corpus Fontium Historiae Byzantinae*, Volumen XII/2: *Chronica Byzantina Breviora*.]

¹³ Franz Babinger, *Mehmet der Eroberer und seine Zeit*, Weltenstürmer einer Zeitwende, München: F. Bruckmann, 1953, f. 68.

¹⁴ Shih për këtë “Kronikën e Mesembrias”, e cila e daton Betejën e Jalomicës, ditën e diel, më 2 shtator 1442. Peter Schreiner, *Die Byzantinischen Kleinchroniken*. 1. Teil. Einleitung und Text. Wien: Österreichische Akademie der Wissenschaften 1975, nr. 29, f. 216.[= *Corpus Fontium Historiae Byzantinae*, Volumen XII/1: *Chronica Byzantina Breviora*.]

Mbi këtë arrati të Skënderbeut nga fushëbeteja e Jalomicës na japin të dhëna “Analet” e Stefano Manjos (Stefano Magno), i cili i referohet një raportit të shkruar nga kronisti venedikas Piero Venier.¹⁶ Kronikat bizantine të cituara më sipër nuk e përmendin Skënderbeun, ngaqë fiksojnë shumë shkurt ngjarje të ndodhura në data të ndryshme dhe për hir të së vërtetës përmendin shumë rrallë edhe figura të tjera që kanë të bëjnë me to.

Beteja e Nishit 1443

Disa kohë më vonë, në vitin 1443 u zhvillua Beteja e Nishit. Skënderbeu ishte njëri nga katër oficerët kryesorë të ushtrisë osmane (krahas Kasim Pashës, Turakhan Beut dhe Isak Beut). Në këtë betejë të Nishit¹⁷ ai dezerton me njërin nga krahët e ushtrisë osmane të përbërë prej 300 kalorësish, shumica e tyre arbërorë. Me këta trupa ai nisët për në Dibër.¹⁸ Kjo ikje e tij duhet të ketë ndodhur më 3 nëntor 1443,¹⁹ çka ishte edhe një ndër shkaqet për humbjen e osmanëve dhe fitoren e Huniadit.

Për sa i përket kësaj beteje, në literaturën historike ekziston edhe një letër e Vladislavit III më 5 korrik 1443 e shkruar në Buda, nëpërmjet së cilës ai i lutet Skënderbeut për ndihmë dhe pjesëmarrje. Skënderbeu në këtë letër përgëzohet nga Vladislavi për kthimin e tij në atdhe dhe për

¹⁵ P. Schreiner, *Die Byzantinischen Kleinchroniken*. 3. Teil. ..., f. 60; shih edhe: Boris Stojkovski, “Ottoman Conquest of Hungary through the Lens of the Byzantine Short Chronicles”, në *Byzanz und das Abendland V*. Studia Byzantino-Occidentalia. Herausgegeben von Erika Juhász, Budapest: Eötvös-József-Collegium, 2018, f. 179.

¹⁶ O. Schmitt, “Matthias Corvinus und Skanderbeg...”, f. 9; shih edhe: Oliver Jens Schmitt, “Die Venezianischen Jahrbücher des Stefano Magno (ÖNB Codd. 6215-6217) als Quelle zur albanischen und epirotischen Geschichte im späten Mittelalter (1433–1477)”, në *Südosteuropa*. Von vor moderner Vielfalt und nationalstaatlicher Vereinheitlichung, Hrsg. von Konrad Clewing und Oliver Jens Schmitt, München: Oldenburg, 2005, f. 137.

¹⁷ “The story that Iskender, fleeing from the camp of Kasim, the beglerbegi of Rum’li (who had been defeated near Niš), seized Akçafriar (Gegaj, 45-6) is probably true.” Halil İnalçik, “Iskender Beg”, në *The Encyclopedia of Islam*, New Edition, Prepared by a number of leading orientalists, Editet by E. van Donzel, B. Lewis, and Ch. Pellat, Volume IV: Iran-Kha (Thirt Impression), Leiden: E. J. Brill, 1997, f. 139.

¹⁸ Oliver Jens Schmitt, *Skënderbeu*, Shqip nga Ardian Klosi, Tiranë: K&B, 2008, f. 68.

¹⁹ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I: Ilirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI – Vitet 20 të shek. XIX, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002, f. 742.

marrjen e kështjellave dhe të territoreve të tij. Pastaj ai i propozon që të marrë pjesë në betejë. Këtu duhet të përmendet se kthimi i Skënderbeut ndodhi pas Betejës së Nishit, në fund të muajit nëntor, ndërsa letra e Vladislavit mban datën 5 korrik 1443, pra, mbi katër muaj para zhvillimit të atyre ngjarjeve.²⁰ Si rrjedhim rezulton që kjo letër duhet të jetë fiktive,

²⁰ Letra e Vladislavit drejtuar Skënderbeut, më 5 qershor 1443: “Mladislaus Hungariae et Poloniae Rex Scanderbego Albanorum Principi salutem plurimam dicit. Distulit fortasse in hoc tempus fortuna seram istam gratulationem nostram, quo nun tantum hodie tibi ob recuperatum feliciter imperium, sed pari etiam prudentia fortitudineque defensum duplici rei prosperae eventu gratularemur. Gratulamur itaque, nec tibi tantum, verum etiam Christianis omnibus, quod tanta sit benignitate Dei per virtutem tuam rei Christianae accessio facta, quandoquidem non minima semper inter caetera mala nostra clades illa ducenda fuit Epiroticae gentis amissio, cum Joannes Castriotus pater tuus princeps, ut audio, de omnium animis optime meritus neque tibi in aliena potestate degenti regnum avitum filio tradere, neque aliter ab Amurate oppressus imperio suo consulere potuit; et viveret utinam nunc felix te nato parens, qui omnium superasset fortunam, si te ante vidisset, quam a vita discederet. Ita una plane videris mihi, pace omnium dixerim, hac tempestate princeps sicut omnibus animi corporisque bonis, ita divino quodam fato praeditus, cujus auspiciis non solum tuta in posterum omnis Epiroticae terrae ora futura sit, sed cuncti praeterea populi a corpore Macedoniae imperii nefario Othomanorum latrocinio jampridem direpti in antiquam formam juris ac ditionis suae redituri. Quid enim (ut caetera taceam, quae et apud barbaros vel puero tibi olim, tanta in dies crescente invidia, maximuni nomen prodiderunt), victoria illa speciosius, quam nuper Alybassa cum tot copiis fugato partam tibi ingenti admiratione aequae audivimus ac credidimus? Et infra, Majoris penitus tibi gloriae materia subest occasio. contra Amuratem omnes veteres novasque tuas ac tuorum injurias ulciscendi, nec privatas istas tantum, sed et publica id genus mala, atque tot oppressae, ne dicam extinctae, Fidei ludibria, si cum victore exercitu isto tuo nondum desperatis rebus nostris adesse velis. Invitant te ad hoc omnes Hungariae et Poloniae principes, ac viri fortissimi; invitat¹ Julianus S. Angeli Cardinalis cuni piis illis Christianae salutis militibus jam diu nobiscum in armis instructus; nihil praeter tua signa exspectamus; quam si nunc oblatam ultro a Deo immortalis occasionem non rejicis, debellari posse penitus omnes affirmant, expellique Turcas, et a tam diutina Europae possessione deturbari. Omittendum itaque hoc loco apud te omne adhortationis genus censeo pro ea causa, quae defensa salutem, lucem, libertatem spondet; amissa numerare horreo; satis nos huc usque tandem deservivimus Christiani, conflagravimus jam omnes, dum nemo incendium ad se trajecturum putat. Quid de Graeco cernimus. quantas de Triballorum imperio jacturas, demum ipsas meas? totque exhausta atque exhaurienda in dies mala quis recenseat? quis fortissimos principes Hungarici imperii propugnacula per omne, aetates amissos, et tot validissimos exercitus eodem funesto bello fato absumptos, ac occidione ferme occisos ita ut nulla sit in Hungaria jam domus, nulla matrona luctus experta? Audiunt haec Christiani principes, neque movet ullum miserabilis sociorum calamitas; sic nos velut piacula quaedam luendis omnium periculis hosti passim obiectari patiuntur. Unus

edhe pse ajo është futur në vëllimin me dokumente të medievisitit të shquar serb Radoniq (Jovan Radonić). Radoniq në këtë rast citon veprën e Marin Barletit, në versionin e botuar në Zagreb në vitin 1743.²¹ Gjithashtu fiktive duhet të jetë edhe përgjigjja që Skënderbeu i dërgon Mbretit Vlasislav, më 4 gusht 1443, e cila po ashtu është marrë prej Radoniqit nga Barleti.²²

Eugenicus sanctissimus Romanae rei Praeses, et Philippus Burgundiae Dux afflictiae fortunae onus non detrectarunt; alter Julianum hunc cum praeclaro milite nobis adiunxit; Philippus classe instructa, et in Hellespontum usque missa Turcis transitum, quantum in ipso fuit, fortiter prohibuit. Alia nunc nobis spes propinqua subest auxilii optandi; quare Ultro nunc ad te ad tam necessarium bellum evocandum virtus tua in primis cognita suasit, tum rerum omnium nostrarum periculum discrimenque coegit. Caeterum cum ignoret nemo id quod nunc sis incommodo acturus tuo, praeter recentem adhuc rerum domesticarum tumultum et vix dum pacatum noviter redempti imperii statum, id te movere non debet, cum et tibi praeclarissimum nomen hac expeditione sis pariturus, et hoc praesens beneficium apud minime ingratos animos sis collocaturus; quod enim prior tu hodie pro salute nostra dignitateque feceris, id nos pro tua laude et imperii incremento semper faciemus, Vale; ex Budua.” J. Radonić, Đurađ Kastriot Skenderbeg ..., dok. nr. 9 (S. 5-6).

²¹ Marinus Barletius, *Vita/et/ Res Praeclare Gestae Christi Athletae/ Georgi/ Castrioti, Epirotarum Principis, qui propter heroicam virtutem suam/ a Turcis/ ScanderBeg,/ id est:/ Alexander Magnus/ cognominatus est,/ libris XIII./A/ Marino Barletio, Scodrensis sacerdote conscripta, denuo/ cum licentia superiorum/ Reimpressa/ Zagrabiae, Typis Joannis Baptistae Weitz, Inclyti Regni/ Croatiae Typographi, Anno 1743, f. 51-53.*

²² Përgjigjja e Skënderbeut për Vladislavin, më 4 gusht 1443: “Scanderbegus Epirensium princeps Vuladislao Hungariae ac Poloniae Regi s. p. d. Accepi litteras tua laetitia desiderioque pari, invictissime Regum, quas cum in maxima dudum meorum frequentia legi iussissem, nemo omnium est auditus, qui tam iusti belli occasionem a te oblatam non ultro adeundam censeret. Ita et publice omnes et privatim dixere, gratus quicquam hodie ab Diis immortalibus sibi tribui non potuisse, quam ut et optimum regem aliquo sibi non ingratorum animorum officio devincirent, et rei christianae simul tam opportunam operam praestarent. Gavisus sum maxime ipse in ea meorum voluntate tum tua in primis, tum communi causa, quum ita animatos pro Christi fide et affectos tibi milites nostros et omnium generum ordines vel sine ulla adhortatione mea viderim. Quamquam quis, nisi Diis pariter et hominibus invisus tam iustissimum bellum recusaverit? Ut nullus sit religionis pudor, nulla communis periculi ratio, pro eo Rege, ad quem, quod regnamus Christiani, quod vivimus, quod spiramus, quod loquimur, unice referre et possumus et debemus. Quis non arma libens sumpserit et in apertum etiam ruat discrimen pro Hungariae populis, quibus tanto malo sanguineque per omnes aetates christianae salutis defensio stetit; qui, vel ab ipsis prope incunabulis aeterni hostium nostrorum hostes, christianae sese dignitati iam inde devoverunt. Utinam vellet Deus opt. Max. Uladislav, ut possem ipse ad hoc praeclarum bellum tibi tantum afferre virium, quantum sum animi et cupiditatis allaturus; non iaceret diutius

Më 27 nëntor 1443 ai u mori osmanëve me dinakëri kështjellën e Krujës dhe një ditë më pas, më 28 nëntor, doli hapur kundër sulltanit²³ dhe u bë zot i principatës tashmë të pavarur të Kastriotëve.²⁴ Qëndrimi i Skënderbeut në ditët e para të nëntorit 1443 gjatë Betejës së Nishit, ku trupat osmane pësuan një disfatë të rëndë, nuk ishte një vendim spontan, por rezultat i një plani të menduar mirë. Supozohet që Skënderbeu duhet të ketë njohur edhe planet e Huniadit dhe të Brankoviçit, prandaj edhe manovrat e tij qenë të shpejta dhe të sakta.²⁵ Studiuesi austriak Julius Pisko shtron disa pyetje në lidhje me qëndrimin e Skënderbeut në këtë betejë:

“A e kishte Skënderbeu si plan tashmë qysh përpara kësaj beteje, ta shfrytëzonte këtë ndeshje, me qëllim që të arratisej për në Arbëri me njerëzit e tij më të besuar? A ekzistonte që më përpara një marrëveshje midis tij dhe Huniadit? A i erdhi atij ideja për të ikur, vetëm atëherë kur ai pa konfuzionin e trupave turke nën komandën e Karaman Pashës? Përgjigjet për këto pyetje duken jashtëzakonisht të vështira, për shkak të mungesës së plotë të dokumenteve historike. Ndërkaq, disa autorë shkruajnë që Skënderbeu tashmë përpara se të zhvillohej beteja i thirri në çadrën e tij arbërit që ishin në mesin e ushtrisë, në mënyrë të veçantë nipin e tij Hamzanë (të birin e Reposhit) që gëzonin besimin e tij të plotë, dhe u bëri atyre të ditura planet e tij.”²⁶

fortasse in eo squalore Europa, ab impio oppressa Amurathe, non velut piaculo quodam aliorum fumarent toties hungarico cruore, Basilienses ac Varnenses campi et epirotico sanguine omnis Macedoniae angulus. Periimus iam omnes, dum quisque sibi se tantum natum existimat. Sed, quid nunc ipse mecum has inutiles quacrelas iacto et nequicquam conqueror? Profecto neque virium me mearum poenitet omnino; neque, si, secundis Diis, acies tecum mihi ad tam felix bellum coniungere licuerit, fortunae nostrae christianum nomen, ut arbitror, unquam poenitebit. Ad ea namque XV milia militum, quae in Macedoniae finibus nuper Alybassam fuderunt, totidem adjicere in animo est. Cum quibus, quamprimum integrum fuerit, ad vos iter arripiam, signa tua in omnem eventurn secuturus. Vale! Ex Croja pridie nonas sextiles MCCCCXLIII.”

Burimi nga Barleti, në J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 10, S. 7.

²³ Klaus-Peter Todt, “Skanderbeg”, në *Biographisch-Bibliographische Kirchenlexikon*. Begr. und hrsg. von Friedrich Wilhelm Bautz. Fortgef. von Traugott Bautz. Bd X. Herzberg: Bautz 1995, Spalte 616.

²⁴ Kristo Frashëri, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Jeta dhe vepra (1405-1468)*, Tiranë: Toena, 2002, f. 133.

²⁵ O. Schmitt, *Skënderbeu ...*, f. 68.

²⁶ J. Pisko, *Skanderbeg ...*, f. 14.

Autorë të tjerë të vjetër, si për shembull dijetari i shquar i shek. XVI, Françesko Sansovino (1521–1586), e përshkruan këtë ngjarje si më poshtë:

“Por përkundrazi, Skënderbeu lutej që hungarezët të ishin fitimtarët. Në fund duke qenë në mes të ushtrive pranë lumit të quajtur Morava, gjenialiteti dhe trimëria e Janosh Huniadit, vojvodës apo kapitenit të përgjithshëm të Vladislavit, mbretit të Hungarisë ishte aq e madhe, saqë me hirin e Zotit, ushtria turke u mund dhe u thye, me gjakderdhje dhe me turp të madh. Nga kjo fitore sa u gëzua Skënderbeu nuk mund të thuhet me fjalë. Megjithatë, ngaqë ai ishte i zgjuar, iku së bashku me turqit, dhe për nder të tij u fsheh në një vend sekret dhe shumë të sigurt.”²⁷

E megjithatë disa historianë kanë rezerva për sa i përket pjesëmarrjes së Skënderbeut në këtë betejë. Për shembull, Kristo Frashëri, dyshon që Skënderbeu të ketë marrë pjesë në Betejën e Nishit, sepse sipas tij, Skënderbeu gjatë kohës që po zhvillohej beteja ka qenë në Dibër, si qeverisës i kësaj krahine.²⁸ Për sa i përket vetë qytetit të Nishit, nga kjo luftë e madhe pësoi një shkatërrim dhe mbeti më pas në duart e Vladislavit III dhe të Janosh Huniadit.²⁹

²⁷ “Ma per cōtrario scād. pregaua Dio che facesse gli Vngari uittoriosi. Alla fine sēdosi cobattuto tra gli duoi seserciti apresso il fiume chiamato Moraua, tanto fu l’ingegno et il ualore di Jancoda Huniad Voiuoda ouer Capitano generale di Vladislao Re di Vngaria, che l’esercito Turchesco fu p Dio gratia superato e rotto, con strage et uergogna gradissima delli Turchi. Della qual uittoria quāto Scand. si rallegrasse a pena dir si potria. Ma cōttuto ciò, esso come astuto si fugì con gli altri Turchi per suo honore in loco secreto & molto sicuro.” Francesco Sansovino, *Historia vniversale dell’origine et imperio de’Tvrcchi*, Raccolta da M. Francesco Sansovino. Nella quale si contengono la Origine, le Leggi, l’Vsanze. I Costumi, cosi Religiosi come mondani de Turchi. [...] Con Privilegio. In Venetia MDLXVIII, f. 343.

²⁸ K. Frashëri, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu ...*, f. 122-124.

²⁹ Fehim Bajraktariëvić [A Popović], “Nish”, në *The Encyclopedia of Islam*, New Edition, Prepared by a number of leading orientalists, Editet by C. E. Bosworth. E. van. Donzel, W. P. Heinrichs and G. Lecomte. Volume VIII: Ned-Sam, Leiden: E. J. Brill, 1995, f. 57.

Beteja e Varnës

Momenti i dytë i marrëdhënieve ndërmjet Skënderbeut dhe Hungarisë fillon po ashtu në vitin 1443, kur Mbreti Vladislav III dhe Janosh Huniadi po përgatiteshin që të ndërmerrnin një kryqëzatë kundër osmanëve. Vladislavi donte që të sulmonte osmanët edhe pse ai kishte bërë një paqe më datë 1 gusht në Szeged, e cila kishte kushte shumë të favorshme për hungarezët.³⁰ Në lidhje me këtë paqe ia vlen të jepen disa të dhëna.

Nga goditjet që Huniadi i kishte bërë ushtrisë osmane dhe ngaqë ai depërtoi thellë në Ballkan, Murati II u habit shumë nga fuqia e kundërshtarit dhe bëri paqe, sipas së cilës për dhjetë vjet nuk do të kishte luftë. Sipas marrëveshjes edhe Serbia dhe Vllahia do të ishin të pavarura.³¹ Kjo paqe kaq e favorshme për Hungarinë u pranua menjëherë edhe nga Vladislavi III dhe që të dy Mbretërit, Vladislavi dhe Murati II, bënë betimin mbi Kur'an e mbi Bibël dhe e firmosën atë. Por në momentin që Papa mori vesh për këtë paqe të bërë, i dha urdhër Huniadit që të niste përsëri luftën. Mirëpo, hungarezët ngurruan dhe i thanë Papës se ishte e pamundur ngaqë kishin bërë paqe.³² Papa iu përgjigj se ishte në gjendje t'i çlironte ata nga kjo paqe dhe shtoi se të krishterët nuk mund ta mbajnë fjalën e dhënë ndaj të pafeve. Si rrjedhim Vladislavi dhe Huniadi qenë gati që të sulmonin sërish tokat e Muratit II, çka e bënë disa muaj më vonë.³³

Filloi kështu një veprimtari diplomatike e gjallë, në të cilën u përfshinë edhe princat arbër, sidomos ata që nuk ishin nën sundimin osman. Supozohet që për këtë që po ndodhte ishte në dijeni edhe Skënderbeu, megjithatë emri i tij nuk përmendet asgjëkund për sa u përket këtyre zhvillimeve.³⁴

Goditja e dytë e kësaj kryqëzate ndodhi në vitin 1444, por nuk pati sukses, sepse despoti serb Gjergj Brankoviq u bë pengesë për ushtrinë e

³⁰ Manfred Hellman, *Daten der polnischen Geschichte*, München: Deutscher Taschenbuch Verlag [dtv], 1985, f. 61.

³¹ F. Schevill, *Ballkani. Historia dhe qytetërimi* ..., f. 162.

³² *Po aty*, f. 163.

³³ *Po aty*.

³⁴ *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, përgatitës për botim Aleks Buda, Xhevat Lloshi, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë: 1985, f. 964.

krishterë³⁵ dhe pengoi edhe marshimin e Skënderbeut përmes Serbisë duke prishur shtigjet e kalimit dhe rrugët. Si rrjedhojë, ushtria e krishterë pësoi një disfatë të rëndë më 10 nëntor 1444, ku gjeti vdekjen edhe Mbreti Vladislav. Ai humbi ekuilibrin, ra nga kali dhe një jeniçer nga Morea i quajtur Hamza (Chamuses) iu afrua duke i prerë menjëherë kokën.³⁶ Ai e nguli kokën e Vladislavit në një shtizë si një trofe dhe ua tregoi atë ushtarëve të krishterë të tmerruar. Demoralizimi për shkak të vdekjes së mbretit u përhap në të gjithë ushtrinë dhe u shndërrua shumë shpejt në panik dhe në ikje të përgjithshme. Huniadi u tërhoq me pjesën tjetër të ushtrisë përmes stepave të Dobrokhës dhe përmes Vllahisë dhe kështu arriti në Hungari.³⁷

Ushtria e aleatëve pati afërsisht 10 000 të vdekur³⁸ (Biemmi flet për 30 000 të vdekur³⁹) ndërsa humbjet e turqve ishin shumë më të mëdha dhe Murati II, pasi pa pas betejës fushën me kufoma, e quajti fitoren e tij “një fitore si të Pirros”.⁴⁰ Sipas Paganel-it, Murati nuk shfaqti asnjë gëzim. I trishtuar dhe i heshtur, ai po vështronte këtë skenë kasaphane: “Pse kjo melankoli pas një fitore të tillë?” - e pyeti veziri i tij. - “A nuk e shihni,” iu përgjigj sulltani, “të gjithë këta besimtarë të vërtetë që shtrihen në pluhur? Mjerë unë, nëse triumfoj shpesh me të njëjtin çmim!”⁴¹ Papa Piu II e përshkruan ndryshe rrjedhën e Betejës në Varnë dhe ia vë fajin Huniadit, i cili, në vend që t’i shkonte për ndihmë mbretit që kishte hapur

³⁵ Oliver Jens Schmitt, *Das venezianische Albanien (1392-1479)*, München: Oldenbourg, 2001, (Südosteuropäische Arbeiten 110), f. 296.

³⁶ Camil Mureșanu, *Janko Hunyadi. Mbrojtës i Krishterimit*, përktheu nga anglishtja Virgil Muçi, Tiranë: Shtëpia botuese 55, 2008, f. 128.

³⁷ Muhamet Mala, *Shqiptarët dhe Evropa Qendrore gjatë shekujve XII-XVII. Me vështrim të posaçëm në marrëdhëniet kroato-hungareze dhe austriake*, Unioni i Bashkësive Shqiptare në Republikën e Kroacisë, Zagreb: 2010, f. 214.

³⁸ J. Pisko, *Skanderbeg ...*, f. 28.

³⁹ Giammaria Biemmi, *Istoria di Giorgio Castrioto detto Scander-Begh*, Seconda Edizione, Brescia: Giammaria Rizzardi, 1756, f. 77.

⁴⁰ J. Pisko, *Skanderbeg ...*, f. 28.

⁴¹ “Aussi Murad ne témoigna-t-il aucune joie. Triste, silencieux, il promenait ses regards sur ce théâtre de carnage: “Pourquoi cette mélancolie après une telle victoire?” lui demanda son vézyr. – “Mais ne vois-tu donc pas,” répondit le Sulthan, „tous ces vrais croyants étendus sur la poussière? Malheur à moi si je triomphais souvent au même prix!” Camille Paganel, *Histoire de Scanderbeg ou Turks et Chrétiens au XV. Siècle*, Ancien Conseiller d’Etat, Paris: Didier, 1855, f. 67.

tashmë betejën, mendoi vetëm për shpëtimin e vet dhe u tërhoq me 10.000 hungarezë dhe vllahë.⁴²

Për shkak të vdekjes së Vladislavit III u shpërbë edhe lidhja e Hungarisë me Poloninë.⁴³ Më pas, në fron erdhi *Ladislavi i Paslindur* (*Ladislaus Postumus*), në moshë fëmimore, i biri i Mbretit Albreht (†1439) që kishte lindur pas vdekjes së të atit, i njohur në histori si *Ladislaus Postumus*. Ai ishte nip i Perandorit Zigismund dhe i biri i princeshës Elizabetë.⁴⁴ Dhe, meqë ishte akoma fëmijë dhe nuk e kishte arritur akoma moshën e pjekurisë, administrimi iu besua Janosh Huniadit, i cili më vonë u bë edhe bashkësundues (bashkëregjent).⁴⁵ Luftërat që po bënin Skënderbeu dhe Huniadi kundër Perandorisë Osmane qenë bërë të njohura në të gjithë Evropën e krishterë tashmë dhe kronistëve të asaj kohe nuk u shpëtoi nga vëmendja as rezistenca e këtyre dy luftëtarëve dhe as ngritja e Huniadit si bashkëregjent i Hungarisë. Ja se çfarë shkruan kronisti raguzan në lidhje me këto ngjarje:

“Por nëse Murati tregohej aq i sjellshëm kundrejt despotit*, që përballë tij bënte madje mëshirë edhe ndaj të tjerëve, nga ana tjetër shpirti i tij ishte i shqetësuar për shkak të Skënderbeut të Epirit. Ky princ arbëror ishte bërë shkëmbi [ajsbergu], ku [ndesheshin e]

⁴²“Verum ipse vt primu cedere Christiana signa conspexit,cum dece millibus Hugaris ac Valachis ex acie se subtraxit, atque insalutato, rege nutante adhuc victoria, fugam arripuit. Fortasse rei militaris perito nulla in pugna salus visa, & saluare aliquos perire omnes maluit”. Pii. II. Pon. Max. Asiae Europaeque elegantissima descriptio mira festiuitate tum veteru[m], tum recentium res memoratu dignas complectens, maxime quae sub Frederico III. apud Europeos Christiani cum Turcis, Prutenis, Soldano, & cæteris hostibus fidei, tum etiam inter sese vario bellorum euentu commiserunt. Accessit Henrici Glareani, Helvetii, poetæ laureati compendiaria Asiæ, Africæ, Europæque descriptio. Parisiis: Apud Galeotum a prato, ad primam Palatij regij columnam. 1534, f. 315.

⁴³ M. Hellman, *Daten der polnischen Geschichte ...*, f. 61.

⁴⁴ *Ladislaus Postumus*, Mbret i Hungarisë dhe i Bohemisë, Dukë i Austrisë, u lind më 22 shkurt 1440 në Komorn (Hungari) dhe vdiq më 23 nëntor 1457 në Pragë. I ati ishte Mbreti Albreht (†1439), e ëma ishte Elisabeta († 1442), e bija e Perandorit Zigismund. Gunther Hödl, “Ladislaus Postumus”, në *Neue deutsche Biographie*, Hrsg. von der Historischen Kommission bei der Bayerischen Akademie der Wissenschaften. Bd.: 13, Krell – Laven. Berlin: Duncker & Humblot, 1982, f. 393.

⁴⁵ M. Mala, *Shqiptarët dhe Evropa Qendrore gjatë shekujve XII-XVII ...*, f. 214.

⁴⁶ Këtu bëhet fjalë për despotin serb Gjergj Brankoviçi. Shih: *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në fondet e Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut*, Dokumente, Hulumtoi dhe përgatiti Gjon Berisha, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë: 2018, nr. XCV.

përmytëshin të gjitha përpjekjet e otomanëve të cilat ishin drejtuar për të dëmtuar krishterimin, e kështu besimtarët pushonin nën mbrojtjen e trimërisë së tij përta i përket anës së detit, ashtu si në krahinat mesdhetare kah Danubi, ku Gjon Korvini, i quajtur Huniadi, i cili u bë guvernator i Mbretërisë së Hungarisë si rrjedhojë e moshës së vogël të Vladislavit të Lindur pas Vdekjes së të atit (Vladislav Postumus), i cili në ato krahina kishte zbrapsur me armë dhe i kishte thyer forcat turke.”⁴⁷

Këtu pra mbyllet edhe ky moment i rëndësishëm rreth marrëdhënieve ndërmjet Skënderbeut dhe Janosh Huniadit. Të vijmë tani te ngjarjet e disa viteve më vonë, te beteja e zhvilluar në Kosovë.

Beteja e Fushës së Mëllenjave (ose Beteja e dytë e Kosovës)

Për sa i përket kësaj lufte të zhvilluar në Kosovë, që njihet edhe si Beteja e dytë e Kosovës, po i kushtojmë një vëmendje të veçantë dhe një hapësirë më të zgjeruar ngaqë zhvillohet edhe në një territor shqiptar. Janosh Huniadi nuk e harroi turpin që pësoi në Betejën e Varnës disa vite më parë dhe kështu vendosi të hakmerrej.⁴⁸ Si rrjedhojë marrëdhëniet ndërmjet Skënderbeut dhe Huniadit mbetën aktive edhe gjatë viteve 1446-1448. Ata donin që të krijonin së bashku një front antiosman në Kosovë.⁴⁹ Historianët, si pjesëmarrës nëpër këto koalicione antiosmane përmendin ndër të tjerë, edhe vojqvodët rumunë Stephan II dhe Vlád II

⁴⁷ “Ma se tanto cortese si mostrava Amuratte verso il despotta, che a riflesso suo faceva delle grazie ad altri, l’animo suo però teneva tutto intento alla depressione di Scanderbeg dell’Epiro. Questo Principe albanese era divenuto lo scoglio, sul quale naufragavano tutti gli sforzi ottomani, diretti a danni della cristianità; e li fedeli si riposavano sotto gli auspici del suo valore dalla parte della marina, come nelle parti mediterranee verso il Danubio Giovanni Corvino, per nome l’Uniade, divenuto governatore del regno d’Ungheria per la minorita di Vladislavo Postumo, assunto a quell regno, aveva fatto rincar, non che depresso le forze turche.” *Chronica Ragusina Junii Restii (Ab origine urbis usque ad annum 1451) item Joannis Gundulac (1451-1484)*, digessit Speratus Nodilo, në: Monumenta spectantia Historiam, Slavorum Meridionalium, Volumen XXV, Scriptores Volumen II, Zagabriae: Ex officinal Societatis Typographicae, 1893, f. 296.

⁴⁸ Lulëzim Lajçi, “Vështrim mbi Luftën e Dytë të Kosovës (17-19 tetor 1448)”, në *Gjurmime Albanologjike*, Seria e shkencave historike, nr. 23-1993, Instituti Albanologjik, Prishtinë: 1995, f. 53.

⁴⁹ 1448 aleanca ndërmjet Skënderbeut dhe Huniadit. K. Frashëri, *Skënderbeu ...*, f. 156.

(Drakula), serbin Gjergj Brankoviç⁵⁰, Skënderbeun dhe Huniadin.⁵¹ Megjithatë studiuesi shqiptar L. Lajçi është i mendimit që ftesës për këtë kryqëzatë antiosmane iu përgjigj ushtarakisht vetëm Skënderbeu, përveç Raguzës, e cila e ndihmoi kryqëzatën vetëm me të holla.⁵²

Huniadi u nis me një ushtri prej 24 000 trupash, të përbëra prej hungarezësh, rumunësh, çekësh dhe gjermanësh dhe kishte planifikuar që të bashkohej me Skënderbeun.⁵³ Vetë Skënderbeu i kishte kërkuar Republikës së Venedikut që ti paguante brenda 15 ditëve një provizion në shumën e 1 400 dukatëve, me arsyetimin se donte t'i shkonte në ndihmë Huniadit.⁵⁴ Më 20 tetor nëpërmjet at Andreas, ipeshkvit të Arbrit që ishte ngarkuar me detyrën e ambasadorit, Skënderbeu i kërkoi ndihmë në formë parash të huazuara edhe Raguzës, duke thënë se donte të shkonte në luftë kundër turqve, porse Republika, ngaqë e kishte ndihmuar atë një vit më parë me 500 libra barat për topa⁵⁵, kësaj here nuk i dhanë ndihmë duke kërkuar ndjesë për këtë.⁵⁶

⁵⁰ Mund të përmendim këtu që Janosh Huniadi kishte një lidhje gati familjare me Gjergj Brankoviçin, sepse djali i madh i Huniadit, Ladislavi, kishte marrë për grua Elisabetën, të bijën e Ulrikut të Cillit (Celje) dhe Katarana Brankoviçit, pra mbesën e Gjergj Brankoviçit. Shih: L. Lajçi, “Vështrim mbi Luftën e Dytë të Kosovës...”, f. 53.

⁵¹ K. Nehring, “Hunyadi, Johann/János ...”, f. 194.

⁵² L. Lajçi, “Vështrim mbi Luftën e Dytë të Kosovës...”, f. 54.

⁵³ M. Mala, *Shqiptarët dhe Evropa Qendrore gjatë shekujve XII-XVII ...*, f. 216.

⁵⁴ “Item perche fato el consiglio fra lor suprascripti i signori de l’Albania, ha determinado, chel suprascripto signor Scanderbego vadi personalmente cum quel piu exercito el pora ad unirse cum el signor Janus, che la prefata signoria de Venexia debia far dar et consignar al prefato signor Scanderbego sopra la sua provision, da mo fina zorni xv. ducati mille quatrocento, da esser diffalcadi in la sua provision.”. *Listine o odnošajih izmedju južnogo Slavenstva i Mletačke republike*, Skupio i uredio Šime Ljubić, Pravi Clan Jugoslavenske Akademije znanosti i umjetnosti ITD, Knjiga IX. Od godine 1423 do 1452, Zagreb: U knjizarnica Jugoslavenske Akademije 1890, f. 283. (cituar më tej: Š. Ljubić, *Listine o odnošajih izmedju...*, IX)

⁵⁵ DAD, Cons. Rog. X, 102: “Prima pars est de donando libras quingentas pueris bombe”. J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 8.

⁵⁶ DAD, Cons. Rog. XI, 14: “Die XX Octobris 1448. Prima pars est de excusando nos a petitione imprestiti denariorum, quam fecit nobis et dominio noster Scanderbech dominus Albaniensis per reuerentem in Xpo patrem D. Adream Episcopum et ambaxiatorem suum, pro eundo contra Tucros una cum exercitu Xprianorum, prout arreatum fuit in presenti Consilio. Captum per 36”. J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 24. (f. 17-18); shih edhe: Ivan Božić, *Dubrovnik i Turska u XIV i XV veku*, Srpska Akademija Nauka, Beograd: 1952, f. 110; L. Lajçi, “Vështrim mbi Luftën e Dytë të Kosovës...”, f. 53.

Skënderbeu dhe Huniadi donin që të sulmonin ushtrinë e Sulltan Muratit II. Sipas një letre të Paskual de Sorgos të datës 11 shtator 1448 drejtuar Brankoviqit, ushtria e Huniadit përbëhej prej 72 000 trupash.⁵⁷

Nga e njëjta letër e Paskual de Sorgos mësohet gjithashtu që formacionet ushtarake të arbërve (*Albanensium ordines*) kishin dërguar te Janosh Huniadi ambasadorë, të cilët i sollën Huniadit premtimin, se ata do të dërgonin njëzet mijë trupa të armatosura. Huniadi i priti ambasadorët me nderime dhe u fali atyre dhurata, porse ofertën e tyre për dërgimin e ushtrisë nuk e pranoi, sepse iu duk si e papërshtatshme.⁵⁸ Ky informacion i nxjerrë nga kjo letër, në lidhje me refuzimin e formacioneve arbërore është tepër ngatërrues dhe bie ndesh edhe me logjikën e ngjarjeve dhe planeve të përbashkëta, megjithatë emri i Skënderbeut në këtë dokument nuk përmendet fare. Aty nuk shkruhet as se nga kush ishte nisur ky delegacion dhe cilët ishin emrat e ambasadorëve. Nuk përjashtohet mundësia që mund të jetë edhe ndonjë e dhënë e pasaktë dhe false. Gjithashtu edhe historiani rumun Pall e sheh këtë të dhënë si të pamundur, sepse edhe shumica e historianëve hungarezë nuk e marrin në konsideratë këtë informacion.⁵⁹ Po kështu, edhe arsytimi se trupat shqiptare paskëshin qenë të papërshtatshme për atë lloj luftime që Huniadi donte të fillonte, duket me të vërtetë shumë i çuditshëm.⁶⁰

Megjithatë plani i bashkimit të ushtrisë së Huniadit me trupat e Skënderbeut konfirmohet nga një dokument i sipërpërmendur i datës 4 tetor, ku thuhet se është bërë paqe në Lezhë ndërmjet Skënderbeut dhe Venedikut. Aty në atë takim qenë të pranishëm edhe Andrea, ipeshkëv i

⁵⁷ “Itemque ex Meldovia equites tria milia ex optimo ordine delecti atque armis egregie muniti, praeterea quos ipse Flaccorum princeps quattuor cum milibus archigeris exercitum sequitur et alii hinc inde sponte sequuti, varijs ordinibus homines ita ut peditum equitumque ad LXX.II. milia homines exercitum complent.” Mark Whelan, “Document. Pasquale de Sorgo and the Second Battle of Kosovo (1448): A Translation”, në *Slavonic and East European Review*, 94/ 1, London: 2016, f. 138-139.

⁵⁸ “Iz Tabora, 11 septembar 1488: Insupervero Albanensium ordines legatos ad Janum ducem miserunt, ut XX armatorum hominum milia sibi hac in expeditione optulari sepollicerentur, quos cum humane honorifique suscepit donatos remisit, exercitum vero ut, minus idoneum et expeditum, bello abnuendum censuerat.” J. Radonić, *Durađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 21 (f. 15).

⁵⁹ T. Pálosfalvi, “Skanderbeg and John Huniadi...”, f. 69.

⁶⁰ Po aty.

Arbrit; Gjergj Pelini, abat i Shën Marisë së Rotecit në Tivari; Paul Loredano, kontkapiten i Shkodrës; Andrea Veniero administrator i Arbërisë e të tjerë, dhe ndër të tjera thuhet:

“Gjithashtu, mbasi u këshilluan ndërmjet tyre të sipërpërmendurit zotërinj të Arbërisë u mor vendimi që i sipërpërmenduri zoti Skënderbe, me sa më shumë ushtri që të mund të mbledhë, të shkojë personalisht e të bashkohet me zotin Janosh dhe që e parathëna Sinjori e Venedikut duhet t’i japë e t’i dorëzojë Skënderbeut të sipërthënë, për llogari të provizionit (pensionit) të tij, rreth njëmijë e katërqind dukatë brenda 15 ditëve, të cilat duhet të zbriten nga ai provizion.”⁶¹

Huniadi kapërceu Danubin në afërsi të Kovinit dhe përmes luginës së Moravës arriti fillimisht në Krushevac, pastaj prej aty, përmes Kopaonikut dhe luginës së Toplicës ai arriti në Sitnica, në afërsi të Prishtinës, ku ishte zhvilluar edhe Beteja e parë e Kosovës.⁶² Ky itinerar përmes luginash të ndryshme duhej të ishte i lehtë për t’u përshkuar nga ushtria e Huniadit, përveç kësaj kjo manovër duhej të ishte njëkohësisht edhe një mbështetje për trupat hungareze që luftonin në Beograd kundër osmanëve.⁶³ Huniadi duhet të ketë mbërritur në Kosovë në mesin e shtatorit 1448, ku vendosi kampin dhe priste Skënderbeun.⁶⁴ Sipas M. Malës, Huniadi kishte qenë edhe në Janjevë (Kosovë), ku kishte marrë pjesë në një meshë në kishën e Shën Kollit për të falënderuar Zotin dhe për fitoret e tij.⁶⁵

Edhe këtë herë Gjergj Brankoviqi (Vukoviqi) nuk e lejoi kalimin e Skënderbeut dhe të trupave të tij.⁶⁶ Duhet të përmendet këtu, që disa nga shkaqet që bënë që Gjergj Brankoviqi të sillej në këtë mënyrë ishin edhe

⁶¹ “1448, 4 octobris. [...] Item perche fato el consiglio fra lor suprascripti i signori de l’Albania, ha determinado, chel suprascripto signor Scanderbego vadi personalmente cum quel piu exercito el pora ad unirse cum el signor Janus, che la prefata signoria de Veniexia debia far dar et consignar al prefato signor Scanderbego sopra la sua provision, da mo fina zorni xv. ducati mille quatrocento, da esser diffalcadi in la sua provision.” Š. Ljubić, *Listine o odnošajih izmedju...*, IX, f. 282-283.

⁶² Kostandin Jireček, *Historia e serbëve*, Pjesa e dytë, Shqipëroi Elda Gjana-Boriçi, Tiranë: Shtëpia botuese 55, 2010, f. 225.

⁶³ Fan S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu 1405-1468*, Tiranë: Naim Frashëri, 1967, f. 96.

⁶⁴ M. Mala, *Shqiptarët dhe Evropa Qendrore gjatë shekujve XII-XVII...*, f. 217.

⁶⁵ *Po aty*.

⁶⁶ F. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu ...*, f. 96.

marrëdhëniet që ai kishte tashmë me Shtëpinë Perandorake të Osmanëve. Brankoviçi ishte bërë tashmë vjehri i Sulltan Muratit II. Murati kishte marrë për grua të bijën e Gjergjit,⁶⁷ e cila nëpër autorë të ndryshëm njihet me emrat Kantakuzina, ose Hierina.⁶⁸ Kjo mund të ketë qenë edhe njëra ndër arsyet, pse ai nuk e lejoi kalimin e Skënderbeut. Nga ana tjetër ndërmjet Brankoviçit dhe Huniadit kishte edhe një armiqësi për shkakun e disa territoreve në jug të Hungarisë, të cilat Huniadi ia kishte marrë, kur ky kishte pranuar vasalitetin e sulltanit.⁶⁹

Përveç pengesës së kalimit të Skënderbeut, Gjergj Brankoviçi i çonte sulltanit edhe të dhëna në lidhje me lëvizjet dhe planet e trupave hungareze. Të dhënat në lidhje me fushatën e planifikuar hungareze Brankoviçi me sa duket i merrte nëpërmjet një fisniku raguzan të sipërpërmendur Paskual Junius de Sorgo⁷⁰, i cili ishte nën shërbimin e Brankoviçit dhe kishte qëndruar madje për njëfarë kohe edhe në kampin hungarez.⁷¹ Në fakt, emri i raguzanit Paskual Junius de Sorgo na shfaqet në shumë dokumente si informator dhe ndërmjetësues midis Republikës së Raguzës, Hungarisë dhe despotit serb.⁷² Sipas Jahja Drançollit, Sorgo kishte shkuar tri herë për bisedime në kampin hungarez, por nuk kishte pasur sukses.⁷³

Skënderbeu vendosi që të bënte kalimin me forcë, megjithatë në këto kushte ai mundi që të avanconte me ngadalë dhe me mundim të madh, sepse rrugët dhe shtigjet ishin bërë të pakalueshme ose ishin shkatërruar. Kështu pak kohë më vonë Skënderbeut i arriti lajmi i disfatës së ushtrisë së krishterë, kur ndodhej në afërsi të Prishtinës.⁷⁴ Sipas J. Xhefersonit, për vonesën e Skënderbeut nuk ishte fajtor Brankoviçi, sepse kjo ndodhi

⁶⁷ K. Frashëri, *Skënderbeu ...*, f. 144.

⁶⁸ J. Pisko, *Skanderbeg ...*, f. 27.

⁶⁹ M. Mala, *Shqiptarët dhe Evropa Qendrore gjatë shekujve XII-XVII...*, f. 216.

⁷⁰ *Po aty*, f. 217.

⁷¹ Bedri Muhadri, "Skanderbeg's Activity during the Period of 1443-1448", në *History Research*, vol. 9, No. 1, Bucarest: 2021, f. 54.

⁷² Shih dokumentet tek: József Gelcich & Lajos Thallóczy, *Diplomatarium Relationum Reipublicae Ragusanae cum Regno Hungariae*, Ragusa és Magyarországgal összeköttetésének oklevéltára. Budapest: Kiadja A. M. Tud. Akadémia Tört. Bizottsága 1887, dok. nr. 273 (f. 459), dok. nr. 304 (f. 531), dok. nr. 306 (f. 528).

⁷³ Jahja Drançolli, "Kosova më 1448 sipas kronikave dhe historive të moçme të Raguzës", në *Kosova-Kosovo*, 17, Prishtinë: 1988, f. 261-262. Cituar sipas: L. Lajçi, "Vështrim mbi Luftën e Dytë të Kosovës...", f. 58.

⁷⁴ K. Frashëri, *Skënderbeu ...*, f. 161.

për shkak të luftërave kundër turqve që Skënderbeu po zhvillonte vetë në vendin e tij.⁷⁵

Njëzet milje larg nga Fusha e Mëllenjave, Skënderbeu po haste tani në mbetjet e trupave të Huniadit, të cilët ishin arratisur nga fushëbeteja.⁷⁶ Në këtë betejë u vra më 19 tetor edhe nipi i Huniadit, Johan Scekel (Johann Székely), vdekja e të cilit ndikoi në mënyrë negative në moralin e trupave të krishtera.⁷⁷ Ashtu si në Betejën e Varnës, kur Huniadi shpëtoi duke marrë arratinë përmes tokave të vojvodës Vlad Drakula që ishte armik i tij, edhe këtë herë Huniadi u përpoq të shpëtonte duke ikur përmes trojeve të despotit serb Gjergj Brankoviçi. Kësaj herë ai u zu rob në një fshat serb dhe Brankoviçi e la Huniadin të lirë, pasi atij iu pagua një shumë prej 100 000 dukatësh.⁷⁸ Derisa shuma të paguhej plotësisht, Huniadi që i detyruar që të linte peng te Brankoviçi djalin e tij më të madh Ladislavin, i cili u la i lirë me rastin e Krishtlindjeve të vitit 1448, pasi shuma u pagua krejtësisht dhe pasi Huniadi kishte bërë edhe një betim ndaj Brankoviçit.⁷⁹

Orientalisti i famshëm austriak Jozef fon Hamer-Purgsthal (Joseph von Hammer-Purgstall), në lidhje me Betejën e Kosovës shprehet si më poshtë: “Ajo (beteja) e Kosovës nuk do të kishte dalë e humbur, nëse Huniadi do të kishte pritë ndihmën e premtuar nga Arbëri, pra ndihmën e Skënderbeut”.⁸⁰ Murati II nuk e shfrytëzoi më tej fitoren e arritur në Kosovë, sepse ai ishte i zënë, qoftë me Tokot (Tocco) në Epir, të cilët i përzuri, qoftë me Skënderbeun, i cili që i detyruar që të paguante një tribut prej 6 000 dukatësh.⁸¹ Kjo betejë në Kosovë ndërmjet Janosh Huniadit dhe ushtrisë osmane të Muratit II u pasqyrua gjerësisht edhe në

⁷⁵ J. Jefferson, *The Holy Wars...*, f. 425.

⁷⁶ M. Mala, *Shqiptarët dhe Evropa Qendrore gjatë shekujve XII-XVII ...*, f. 219.

⁷⁷ *Po aty*, f. 218-219.

⁷⁸ K. Jireček, *Historia e serbëve...*, II, f. 225; shih edhe: M. Mala, *Shqiptarët dhe Evropa Qendrore gjatë shekujve XII-XVII ...*, f. 219.

⁷⁹ K. Jireček, *Historia e serbëve ...*, II, f. 226.

⁸⁰ “Die von Kossowa wäre nicht verloren worden, hätte Hunyadi die aus Albanien versprochene Hülfe erwartet, die Hülfe Skanderbeg’s.” Joseph v. Hammer-Purgstall, *Geschichte des Osmanischen Reiches*. Band 1. Einleitung und Bibliographie Herbert W. Duda. Graz: Akademischer Druck und Verlagsanstalt, 1963, f. 480.

⁸¹ K. Jireček, *Historia e serbëve...*, II, f. 226.

burimet dhe kronikat osmane⁸², por pasqyrimi i tyre këtu do ta kapërcente kuadrin e këtij artikulli.

Pas kësaj beteje, edhe pse aksi Skënderbeu-Huniadi ishte dobësuar,⁸³ informacionet rreth Arbërisë dhe luftës së Skënderbeut vazhduan të vinin edhe më pas, sepse fitoret e njërit pasqyroheshin edhe tek tjetri. Kështu, Senati i Raguzës e informon Janosh Huniadin me anë të një letre të datës 13 gusht 1450 në lidhje me mbrojtjen e kështjellës së Krujës nga Skënderbeu si më poshtë:

“Perandori turk me të birin mban në këmbë një ushtri të fuqishme në trojet e Arbërisë, dhe ka hapur llogore kundër Krujës, qytetit të Skënderbegut. Ai përpiqet me të gjitha forcat e me luftë shumë të ashpër që ta shtie në dorë e ta shtypë këtë qytet. Prandaj, mbasi vendosi forcat rreth qytetit të sipërpërmendur, dha urdhër që nga metali që kishte sjellë me vete, të bëheshin dy topa, më i madhi prej të cilëve, sipas njoftimeve që kemi, mund të hedhë një shkëmb me peshën e 400 librave. Megjithatë qyteti është i forcuar dhe armatosur me të gjitha ato mjete, të cilat janë të nevojshme për mbrojtjen e ruajtjen e tij, dhe vendi vetë mund të shtihet me vështirësi në dorë për arësye të ashpërsisë së maleve. Përveç kësaj, në të (në qytet) mbrenda janë 1500 burra shumë të sprovuar për ta mbrojtur. Për këtë arsye besohet se ushtria turke e përmendur më sipër kot mundohet ta shkatërrojë atë qytet, ngaqë brenda tij ka burra që kanë lidhur besën (për ta mbrojtur). Vetë Skënderbeu nuk ndodhet larg llogoreve turke, dhe ai për çdo ditë i shkakton dëme të mëdha (armikut), ngaqë përfiton nga natyra e vendit e nga malet, ku mund të tërhiqet i sigurt e pa u rrezikuar. Në qoftë se na vijnë lajme të tjera që vlejné për relacion, do të mundohemi që ta lajmërojmë vazhdimisht Shkëlqesinë tuaj.”⁸⁴

⁸² Këtu mund të përmendim kronikën e Oruxhit, në: *Lufta Shqiptaro-Turke 1370-1530. Burime Osmane*, përgatiti për shtyp Selami Pulaha, Tiranë: Helga's Secrets, 2016, f. 51-63; Kronika e Ali Beut, në *po aty*, f. 254; Kronika e Mehmet Neshriut, në *po aty*, f. 85-103; Krahaso: L. Lajçi, “Vështrim mbi Luftën e Dytë të Kosovës...”, f. 58-60.

⁸³ O. Schmitt, “Matthias Corvinus und Skanderbeg...”, f. 10.

⁸⁴ “[...] Teucrorum imperator cum eius filio in partibus Albanie validissimos tenet exercitus et contra Croiam, civitatem Schanderbechi, castramentatus est, quam totis viribus et acerrimo bello oppugnare atque opprimere conatur. Conflari enim iussit, postquam castra posuit contra dictam civitatem, ex metallo, quod secum deferri fecerat, bombardas duas, quarum maior, sicuti veris relatibus habuimus, proicit lapidem ponderis li brarum quadringentarum. Civitas autem ipsa munitissima est

Në vitin 1455 kemi dy letra që i dërgohen Janosh Huniadit në lidhje me kërcënimet osmane kundër trojeve arbërore. Të dyja këto letra vijnë nëpërmjet raguzanëve. E para letër është e datës 11 qershor 1455, e cila i dërgohet Huniadit nga qytetarë raguzan, të cilët me sa duket, duhet të kenë qenë anëtarë të komunitetit raguzan të qytetit të Novobërdës (në dokument Novemontis) në Kosovë, aty figuron edhe ipeshkvi i Varazhdinit (*episcopus varadiensis*). Me anë të kësaj letrë i kërkohej Janosh Huniadit ndihmë kundër sulltanit të egër të turqve, i cili kishte arritur tashmë qytetin me një ushtri të madhe në numër me lloj-lloj instrumentesh lufte të papame e të padëgjuaara ndonjëherë dhe rrezikonte ta pushtonte atë krejtësisht.⁸⁵ Ata i drejtohen Huniadit direkt me fjalët:

“Eja, pra pa vonesë, ti o i madhi e i pamoshturi prijës, sepse i gjithë populli i hodhi sytë tek ti e të zgjodhi, dhe se je i vetmi që je i fortë mjaftueshëm dhe ke guxim për t'i dalë armikut me aq tërbim e me na ardhë në ndihmë.”⁸⁶

Letra e dytë i përket datës 20 nëntor 1455 dhe niset nga Ragusa, nëpërmjet së cilës Huniadi informohet shkurt për dëmet e shkaktuara në Arbëri nga osmanët.⁸⁷

Edhe pse nuk disponojmë një korrespondencë, lidhjet ndërmjet Skënderbeut dhe Huniadit nuk u ndërprejnë, derisa Huniadi vdiq më 11 gusht 1456 për shkak se ishte infektuar nga murtaja, menjëherë pas

omnium earum rerum, que ad eiusdem defensionem et conservacionem necessarie sunt, nec locus ille, ad quem propter moncium asperitate difficilis aditus est, satis commode debellari potest. In eo preterea assunt viri 1500 ad defensionem aptissimi. Ex quo creditur, dummodo inter se sunt viri, qui fidem servant, exercitus predictus contra civitatem illam frustra moliri. Schanderbechus quoque non longe est Teucrorum castris; eisque in dies maxima damna infert, cum habeat locorum et moncium opportunitatem, in quibus se tuto recipere potest. Si quid in futurum ad nos delatum fuerit, quod nova relazione dignum sit, excellenciam vestram curabimus continuo certiore efficere” J. Radonić, Đurađ Kastriot Skenderbeg ..., dok. nr. 31 (S. 19-20); shih edhe tekstin e plotë tek: J. Gelcich, L. Thallóczy, *Diplomatarium Relationum*..., f. 473-474; shih edhe: Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti* ..., dok. nr. CVII.

⁸⁵ “Ecce ferocissimus Teucrorum imperator acerrimus et communis omnium hostis numerosissimo exercitu, variisque et inauditis instrumentis Novimontis civitatem invasit, barbaro milite eam penitus expugnare contendit.” J. Gelcich, L. Thallóczy, *Diplomatarium Relationum*..., f. 581.

⁸⁶“Eia age, tolle moras, dux magnanime et invicte, totus enim populus oculos coniecit et preelegit, qui solus possis et valeas tanto furori succurrere pariter et occurrere.” *Po aty*.

⁸⁷ DAD, Lett. et Comm. di Lev., vol. XVI (1454-1460), fol. 175r. Cituar sipas Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti* ..., nr. CXXVI.

mbrojtjes që i kishte bërë qytetit të Beogradit.⁸⁸ Pas vdekjes së papritur të Mbretit hungaro-kroat Ladislaus V në nëntor të vitit 1457 në Pragë, Mbret i Hungarisë bëhet pikërisht Matias Korvini, i biri i Janosh Huniadit, i cili e vazhdoi politikën e të atit menjëherë sa erdhi në fron.⁸⁹ Mbreti Martias Korvini për herë të parë eci edhe në gjurmët e babait të tij Huniadit, kur në vjeshtën e vitit 1458 i theu trupat osmane në kufijtë e mbretërisë.⁹⁰

Skënderbeu dhe Matias Korvini

Për sa u përket marrëdhënieve ndërmjet Korvinit dhe Skënderbeut, mund të themi që ato vazhduan, sepse edhe Papa Kaliksti III i kishte thënë mbretit kur po kurorëzohej, që ta vazhdonte atë që kishte lënë i ati dhe i kishte rekomanduar atij shprehimisht edhe Skënderbeun e Arbërisë.⁹¹ Matias Korvini e respektoi dëshirën e Papës dhe kështu, për llogari të Korvinit Senati i Raguzës më 24 shkurt 1459 dërgoi te Skënderbeu një ambasador, i cili quhej Stupko de Nondaralba (*Stupco de Nondaralba*)⁹² me një anije raguzane⁹³ dhe kostot e udhëtimit të tij u

⁸⁸ M. Mala, *Shqiptarët dhe Evropa Qendrore gjatë shekujve XII-XVII ...*, f. 222.

⁸⁹ O. Schmitt, "Matthias Corvinus und Skanderbeg...", f. 10.

⁹⁰ Po aty.

⁹¹ Po aty.

⁹² DAD, Lett. et Comm. di Lev. 1454-60. fol. 73: "Regi Hungarie ..., die 24. Februarii 1459. Serenissime princeps et excellentissime domine, domine nostersingularissiine. Post humillimam commendacionem ad maiestatis vestre pedes. Celsitudo vestra literis suis nos requirit, ut nobilem eius dilectum, Stupchum de Nandaralba, quem ad illuistrem Schenderbegh transmittit, tam in eundo, quam in redeundo tuto associari faciamus. Nos maiestatis vestre mandata libentes complexi sumus. dictumque Stupchum et hic Ragusii bene tractavimus, et communis nostri sumptibus per cibam propriam eum a nobis ad ipsum illustrem Schenderbegh traieimus. Redeuntem autem, ut et celeriter et tute ad maiestatem vestram se referat, curabimus. De oratoribus nostris, quorum adventu celsitudo vestra optare scribit, nil aliud dicendum est, nisi eos ante receptionem literarum hinc expediverimus, quos iam serenitatis vestre pedes appulisse deo duce confidimus." J. Gelcich, L. Thallóczy, *Diplomatarium Relationum...*, dok. nr. 364 (f. 612-613.)

⁹³ "Die XVIII Februarii 1459. Prima pars est de dando facultatem domino Rectori et suo Minori consilio, quod possunt facere expensam opportunam pro una barcheta ad transmittendum nuncium domini nostri regis Hungarie in Albaniam ad Schenderbegh. Captum per omnes." J. Radonić, *Durađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 175 (f.106.)

morën përsipër nga Republika e Raguzës.⁹⁴ Po në të njëjtën kohë, një dokument i datës 18 shkurt na jep të dhëna edhe për kërkesën që i bëhet magjistrit Gjon Gazulli që të shkojë te Mbreti hungarez Matias Korivini, me shpenzimet e Republikës.⁹⁵ Nondaralba i lartpërmendur nuk arriti kurrë te Skënderbeu, pasi u ther me thikë dhe vdiq po në atë anije gjatë udhëtimit të tij për në Arbëri.⁹⁶ Kurse në lidhje me nisjen e Gjon Gazullit, nuk kemi asnjë të dhënë tjetër, se shkoi apo jo dhe se cili ishte misioni i tij. Emri i tij përmendet edhe një herë një muaj më vonë, ku cilësohet si ambasador i Skënderbeut të madhërishtëm, dhe se i jepej leje për t'u përgjigjur. Më tej në dokument nuk mësohet gjë tjetër.⁹⁷

Më datë 3 prill të po atij viti (1459), nga një dokument i Këshillit të Rogatëve të Raguzës, mësojmë edhe për ekzistencën e një ambasadori tjetër të mbretit hungarez, që kishte shkuar te Skënderbeu dhe ishte kthyer në Raguzë, dhe aty bëhet fjalë për një shumë prej 10 dukatësh që duhej t'i jepej këtij ambasadori.⁹⁸ Nga këto dokumente nuk mësojmë pra se cilat ishin misionet dhe porositë e këtyre ambasadorëve dhe cilat qenë bisedimet që mund të jenë bërë. Megjithatë, një gjë del në pah, që shkëmbimet ndërmjet Skënderbeut dhe Korvinit gjatë vitit 1459, siç e paraqesin këto dokumente, duhet të kenë qenë të shpeshta.

Matias Korvini u përpoq disa herë që të sillte sulmet e tij kundër osmanëve në një harmoni me ato të Skënderbeut, por këto përpjekje mbetën pa sukses.⁹⁹ Si një shembull i rëndësishëm për këto përpjekje

⁹⁴ “De dando facultatem domino rectori at suo minori consilio, quod possunt facere expensam opportunam pro una barcheta ad transmittendum nuncium domini nostri regis Hungarie in Albaniam ad Schenderbegh. Per omnes.” J. Gelcich, L. Thallóczy, *Diplomatarium Relationum...*, dok. nr. 16 (f. 745).

⁹⁵ “18. Februarii. 1459 De rogando magistrum Iohannem Gazulum, quod vadat ad maiestatem serenissimi domini nostri regis Hungarie, offerendo expensas ipso magistro Iohanni. Pes 34 contra 0, inc. 4. - De dando dicto magistro Iohanni Gazulo pro expensis in totum ducatos auri centum. Per 21 contra 12, inc. 0.” *Po aty*, dok. nr. 16 (f. 745).

⁹⁶ O. Schmitt, “Matthias Corvinus und Skanderbeg...”, f. 10.

⁹⁷ “1459, 17. Marcii. De dando libertatem domino rectori et minori consilio respondendi domino Paulo Gazulo ambassatori magnifici domini Schenderbegh, prout arreatum fit in presentj consilio. Per 31 contra 0, inc. 0.” J. Gelcich, L. Thallóczy, *Diplomatarium Relationum...*, dok. nr. 16 (f. 746).

⁹⁸ DAD, Acta Cons. Rog., Vol. XVI (1459-1461): “1459, 3. Aprilis. De donando ambassatori maiestatis regis Hungarie, qui fit ad Schenderbegh. Per 27 contra 6, inc. 0. - De donando sibi ducatos decem. Per 26 contra 7, inc. 0.” *Po aty*.

⁹⁹ M. Mala, *Shqiptarët dhe Evropa Qendrore gjatë shekujve XII-XVII ...*, f. 224-225.

antiosmane nga ana e Korvinit mund të përmendet këtu kryqëzata e planifikuar nga Papa Piu II, Matias Korvini dhe Venediku në vitet 1463/64, në të cilën edhe Skënderbeu do të luante një rol të rëndësishëm. Kjo kryqëzatë kundër osmanëve dështoi dhe, si shkaqe kryesore mund të përmendet qoftë vdekja e papritur e Papës më 14 shkurt 1464 në Ankona,¹⁰⁰ qoftë edhe politika perëndimore që po bënte Mbreti i ri i hungarezëve Matias Korvini.¹⁰¹ Me përfundimin e çështjes së kryqëzatës mbaron edhe përpjekja e tretë e madhe për një sulm të përgjithshëm në formë dare në marrëveshje ndërmjet Skënderbeut dhe Huniadëve.¹⁰²

Sipas O. J. Shmitit, “kur Matias Korvini pas dështimit të tij në Bosnjë (1464) iu kthye Perëndimit, armiqësisë së tij me Perandorin Frederik, presioni që ishte ushtruar gjithnjë mbi osmanët nga ana e Danubit u zmbars dhe rruga e tyre në drejtim të Adriatikut qe e hapur. Kështu Skënderbeut iu desh që të paguante çmimin e tij për ëndrrat austriake dhe bohemiane të Korvinit.”¹⁰³

Megjithatë, marrëdhëniet ndërmjet Skënderbeut dhe Matias Korvinit nuk duket se mbarojnë me kaq. Pas vitit 1464 ka disa dokumente, të cilat tregojnë edhe kontakte të tjera të mëvonshme ndërmjet tyre. Kronika raguzane e Junius Restit njofton se në verën e vitit 1465 Sulltan Mehmeti II me dy ushtri të fuqishme po përpiquej të hynte në Hungari, dhe, mbasi të ndizte flakë e ta shkatërronte me hekur atë vend, synonte të rrethonte e të pushtonte Beogradin.¹⁰⁴ Një pasha i tij, të cilit në kronikë nuk i jepet emri, i ishte afruar tashmë Smederevos dhe jo shumë larg tij po vinte edhe Mehmeti së bashku me të birin e tij më të madh. Synimi i sulltanit ishte të pushtonte Serbinë dhe Jaucen e të ripushtonte Bosnjën. Duke pushtuar këtu dy vende, sulltani mund të hynte pastaj më lehtë në Hungari, Bohemi dhe në Dalmaci e më tutje në Itali e Gjermani.

Në këto kushte Matias Korvini çoi ambasadorë te Papa dhe te Skënderbeu. Te Skënderbeu u nis frati P. Aleksandër, i cili duke kaluar

¹⁰⁰ J. Pisko, *Skanderbeg ...*, f. 100.

¹⁰¹ Oliver Jens Schmitt, *Skanderbeg. Der neue Alexander auf dem Balkan*. Regensburg: Friedrich Pustet, 2009, f. 329.

¹⁰² O. Schmitt, “Matthias Corvinus und Skanderbeg...”, f. 13.

¹⁰³ “Als sich Matthias Corvinus nach seinem Scheitern in Bosnien (1464) dem Westen, seiner Fehde mit Kaiser Friedrich, zuwandte, wich der Druck, der von der Donau stets auf die Osmanen gelastet hatte: Ihr Weg an die Adria stand frei. So zahlte Skanderbeg den Preis für die österreichischen und böhmischen Träume des Corvinen.” O. Schmitt, *Skanderbeg...*, f. 329.

¹⁰⁴ *Chronica Ragusina Junii Restii ...*, f. 372.

nëpër Raguzë kërkoi që edhe Republika të dërgonte bashkë me të ambasadorin e saj dhe Raguza dërgoi fisnikun Nikolo Bona (Nicolò Bona).¹⁰⁵ Sipas një dokumenti të datës 12 gusht, shoqëruesi i fratit P. Aleksandër, në fillim ishte caktuar fisniku Paladinus Lukaris¹⁰⁶, por që nuk pranoi dhe kështu u caktua Marinus VI de Bona¹⁰⁷ (e jo Nikolò Bona, siç e jep kronika e Junius Restit).

Një dokument i fundit që ka lidhje me marrëdhëniet e Skënderbeut me Matias Korvinin është ai i datës 13 nëntor 1466, ku bëhet fjalë për një fisnik raguzan sër Paladino de Gondola, i cili kishte shprehur dëshirën, e ishte treguar i gatshëm për të shkuar te mbreti hungarez si ambasador i Skënderbeut. Por Këshilli i Rogatëve mori vendimin që të mos ia besojë këtë detyrë atij, megjithatë ta falenderojë atë për këtë ofertë të mirë.¹⁰⁸

Fundi i marrëdhënieve dhe jehona e mëvonshme

Me këto ngjarje të vitit 1464 dhe me kontaktet e disa viteve më pas që përmendem më sipër, po i afroreshin fundit jo vetëm marrëdhëniet miqësore ndërmjet Shtëpive Huniadi dhe Kastrioti, por edhe një traditë 20-vjeçare planesh të sulmeve regjionale¹⁰⁹ kundër osmanëve. Vdekja e Skënderbeut më 17 janar 1468 i solli frontit antiosman edhe një goditje tjetër me pasoja shkatërruese.

Pas periudhës së Skënderbeut marrëdhëniet midis dy vendeve u bënë gjithnjë e më të dobëta dhe nëpërmjet pushtimit osman të trojeve arbërore ato u shkëputën krejtësisht. Sipas Shufflajt, “kur në vitin 1479 Arbëria ra përfundimisht në duart e turqve, në Hungari pati gjithashtu një jehonë të madhe. Në arkivin e qytetit të Brasovit, për shembull, ruhen edhe dy letra sllave që u drejtohen qytetarëve të Brasovit, dhe këshillit të qytetit. Në to vojvoda hungaro-vllah njofton si diçka veçanërisht të rëndësishme dhe në mënyrë shumë të saktë rënien e kështjellave kryesore arbërore të Krujës,

¹⁰⁵ *Po aty*.

¹⁰⁶ DAD, Acta Cons. Rog., Vol. XVIII (1463-1466), në Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti ...*, dok. nr. CCIX.

¹⁰⁷ J. Gelcich, L. Thallóczy, *Diplomatarium Relationum...*, dok. nr. 16 (f. 746).

¹⁰⁸ “13. Novembris. De non committendo aliquid ser Paladino de Gondola, ituro ad serenissimum dominum Hungarie regem ex parte Schenderbeghi, sed sibi regraciando pro sua bona oblacione. Per 20 contra 16.” *Po aty*, f. 780.

¹⁰⁹ O. Schmitt, *Skanderbeg...*, f. 329.

Drishtit, Lezhës dhe rrethimin e plotë të Shkodrës.”¹¹⁰ Pushtimi i Arbërisë nga osmanët solli një shkëputje përfundimtare të çdo lloj marrëdhënieje midis dy vendeve dhe dy popujve.

Sot, pasi kanë kaluar mbi 500 vjet emrat e të dy heronjve, të Skënderbeut dhe të Janosh Huniadit, pra të këtyre dy figurave të rëndësishme për identitetet e të dy popujve nderohen dhe mbahen në kujtesë të gjallë qoftë në Hungari, qoftë në Shqipëri. Sot në

Tiranë ekziston një rrugë, e cila mban emrin e Janosh Huniadit, kurse në vitin 2018 u bënë bisedime për vendosjen e një monumeti të Skënderbeut në Budapest. Ky monument duhej të vendosej në afërsi të statujës së Janosh Huniadit dhe kjo gjë u realizua në muajin korrik të vitit 2021.¹¹¹



Fig. 2: Presidenti hungarez János Áder dhe Presidenti shqiptar Ilir Meta vendosin kurorë me lule gjatë inaugurimit të bustit të Gjergj Kastriotit Skënderbeut në Platán-Promenade në Városliget, më 5 korrik 2021. (Photo: MTI / TiborIllyés) burimi: *budapest.hu* (31. 8. 2021)

* * *

Kjo pra ishte një paraqitje e shkurtër e marrëdhënieve të Skënderbeut me Shtëpinë e Huniadëve, një tematikë që kërkon një vëmendje të

¹¹⁰ “Als im Jahre 1479 Albanien endgültig in die Hände der Türken fiel, gab es auch in Ungarn einen gewaltigen Widerhall. Im Archiv der Stadt Brassó zum Beispiel werden zwei slawische Briefe, an zwei Brassóer Bürger und an den Stadtrat gerichtet, aufbewahrt. In diesen meldet der ungar-walachische Woiwode als besonders wichtig und sehr genau den Fall der albanischen Hochburgen Kroja, Drivast, Alessio und das vollständige Zernierung Skutaris”. Milan Šufflay, “Ungarisch-Albanische Berührungen”, në *Illyrisch-Albanische Forschungen*, Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček [u. a.]. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte, München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 298.

¹¹¹ A statue was erected for Skanderbeg, an ally of János Hunyadi, in the Városliget. URL:

https://pestbuda.hu/en/cikk/20210705_a_statue_was_erected_for_skanderbeg_an_ally_of_janos_hunyadi_in_the_varosliget (aksesuar më datë: 31.08.2021)

veçantë jo vetëm për lidhjet e shkëmbimet që kanë pasur Skënderbeu dhe Janosh Huniadi, por edhe për rezistencën dhe luftën antiosmane që kanë zhvilluar, jo vetëm hungarezët dhe arbrit në veçanti, por edhe popujt e Ballkanit në përgjithësi.



Fig. 3: Shatërvani në shehin Huniadi në qendër të Tiranës.

Foto: Edmond Malaj, Dhjetor 2021

S u m m a r y

THE ANTI OTTOMAN WAR AND THE RELATIONS BETWEEN SCANDERBEG AND JÁNOSH HUNYADI AND HIS SON MATTHIAS CORVINUS

The article deals mainly with Skanderbeg's relations to Johannes Hunyadi, one of the most important figures of the anti-Ottoman war in Europe. Later he became also one of the most important heroes for the Hungarian Identity. In addition to these relations have been briefly treated those with Hunyadi's son, Matthias Corvinus, who became later king of Hungary. Concerning these relations, I have given some central information. These data are extracted from many historical works and from documents that are given in this work in both forms, in translated versions and the original language.